

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Raportimi Financiar  
i Avancuar**

**P9**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

*Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme*

Data 18.01.2025

1. Draft pasqyrat e pozitës financiare më 31 dhjetor 2024 për Fehmiu sh.a dhe kompanitë në të cilat ka investuar Moisiu sh.a dhe Tosca sh.a janë si më poshtë:

**Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2024.**

<b>Pasuritë</b>	<b>Fehmiu €'m</b>	<b>Moisiu €'m</b>	<b>Tosca €'m</b>
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>			
Prona, impiantet e prodhimit dhe pajisjet	500	225	210
Investimet në:			
Moisiu	205		
Tosca	<u>165</u>		
	870	225	210
Pasuritë qarkulluese	<u>232</u>	<u>125</u>	<u>95</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>1,102</b>	<b>350</b>	<b>305</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>			
<i>Ekuiteti:</i>			
Kapitali aksionar	50	25	25
Fitimet e mbajtura	563	160	175
Rezervat tjera	<u>189</u>	<u>55</u>	<u>50</u>
	802	240	250
Detyrimet afatgjata	175	63	30
Detyrimet afatshkurta	<u>125</u>	<u>47</u>	<u>25</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>1,102</b>	<b>350</b>	<b>305</b>

**Informata tjera:**

- i) Fehmiu sh.a kishte blerë fillimisht 35% të kapitalit aksionar të Moisiu sh.a më 1 janar 2019 me një kosto prej €50 milionë kur fitimet e mbajtura dhe rezervat e tjera të Moisiu sh.a arritën respektivisht në €80 milionë dhe €10 milionë. Vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të Moisiu sh.a më 1 janar 2019 ishte e barabartë me vlerat e tyre në libra.

Fehmiu sh.a bleu edhe 45% të kapitalit aksionar të Moisiu sh.a më 1 janar 2021 me një kosto prej €87 milionë kur fitimet e mbajtura dhe rezervat e tjera të Moisiu sh.a arritën në €105 milionë dhe €15 milionë respektivisht. Vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të Moisiu më 1 janar 2021 arriti në €150 milionë. Diferenca midis vlerës së drejtë dhe vlerës në libra të pasurive neto të Moisiu sh.a në atë datë i atribuohet impianteve të prodhimit dhe pajisjeve të cilat kishin një jetë të dobishme ekonomike të mbetur prej 10 viteve me 1 janar 2021. Vlera e drejtë e një pronësie prej 35% në kapitalin aksionar të Moisiu sh.a më 1 janar 2021 ishte €68 milionë.

Fehmiu sh.a ka zgjedhur politikën e vlerësimit të interesit jo-kontrollues sipas vlerës së drejtë në lidhje me blerjen e Moisiu sh.a në përputhje me SNRF 3 *Kombinimet e Biznesit*. Një pronësi prej 20% në kapitalin aksionar të Moisiu sh.a kishte një vlerë të drejtë prej €39 milionë më 1 janar 2021.

- ii) Fehmiu bleu 60% të kapitalit aksionar të Tosca sh.a më 1 janar 2023 me një kosto prej €130 milionë kur fitimet e mbajtura dhe rezervat e tjera të Tosca sh.a arritën në €140 milionë dhe €22 milionë, respektivisht. Vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të Tosca sh.a më 1 janar 2023 ishte €200 milionë. Diferenca midis vlerës së drejtë dhe vlerës në libra të pasurive neto të Tosca sh.a në atë datë i atribuohet impianteve të prodhimit dhe pajisjeve të cilat kishin një jetë të dobishme ekonomike të mbetur prej 5 viteve me 1 janar 2023.

Fehmiu sh.a ka zgjedhur politikën e vlerësimit të interesit jo-kontrollues sipas pjesës proporcionale në neto pasuritë e identifikueshme në lidhje me blerjen e Tosca sh.a në përputhje me SNRF 3 *Kombinimet e Biznesit*. Një pronësi prej 40% në kapitalin aksionar të Tosca sh.a kishte një vlerë të drejtë prej €87 milionë më 1 janar 2023.

- iii) Më 1 tetor 2024, Fehmiu sh.a shiti një pronësi prej 5% të kapitalit aksionar në Tosca sh.a për të ardhurat në para në vlerë prej €15 milionë. Çdo fitim ose humbje nga shitja është llogaritur saktë në pasqyrat financiare të veçanta të Fehmiu sh.a. Vlera në libra e investimit të Fehmiu sh.a në Tosca sh.a në pasqyrën e pozitës financiare më sipër lidhet me vlerën e drejtë të pronësisë 55% të mbetur në 31 dhjetor 2024. Fitimi dhe të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse të Tosca sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024 arritën në €18 milionë dhe €12 milionë, respektivisht. Mund të supozohet se fitimet dhe të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse kanë ndodhur në mënyrë të njëtrajtshme gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2024.
- iv) Të dy investimet në Moisiu sh.a dhe Tosca sh.a janë klasifikuar saktë si zëra me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes në pasqyrat financiare të veçanta të Fehmiu sh.a më sipër në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet Financiare*.
- v) Nuk kishte pasur humbje nga dëmtimi në lidhje me investimet në Moisiu sh.a dhe Tosca sh.a përpara 1 janarit 2024. Një rishikim i investimeve në Moisiu sh.a dhe Tosca sh.a si Njësi Gjeneruese të Parasë në 31 dhjetor 2024 tregon se shumatat e tyre të rikuperueshme në atë datë janë €265 milionë dhe €255 milionë, respektivisht.
- vi) Stoqet e Tosca sh.a më 31 dhjetor 2024 përfshin mallrat e blera nga Moisiu sh.a me një kosto prej €20 milion. Moisiu sh.a i kishte faturuar këto mallra me një marzhë mbi kosto prej 25%.
- vii) Më 1 janar 2024, Fehmiu sh.a shiti një ndërtesë e cila kishte një vlerë në lira në atë datë prej €50 milion një pale të tretë të palidhur për €60 milionë kur vlera e drejtë e ndërtesës ishte €65 milionë. Fehmiu sh.a e morri menjëherë ndërtesën me qira për një afat 10-vjeçar, i cili ishte gjithashtu jeta e dobishme ekonomike e mbetur e ndërtesës më 1 janar 2024. Në arritjen e draft pasqyrës së pozitës financiare më sipër, Fehmiu sh.a e ka çregjistruar ndërtesën dhe ka raportuar një fitim nga shitja në vlerën €10 milionë në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Sipas kontratës së marrjes përsëri me qira, Fehmiu sh.a paguan një qira vjetore prej €9.8 milion më 31 dhjetor në fund të çdo viti. Qiraja e paguar më 31 dhjetor 2024 është ngarkuar si shpenzim në fitim ose humbje. Supozoni se norma e interesit e

aplikueshme për huamarrjet e Fehmiu sh.a është 10%. Fehmiu sh.a përdor modelin e kostos sipas SNK 16 *Pronat, impianti dhe pajisjet* në matjen e ndërtesave, duke i zhvlerësuar ato në bazë drejtvizore.

**Kërkohet:**

**Përgatitni pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare të grupit Fehmiu sh.a më 31 dhjetor 2024. (30 pikë)**

**Shënim: Rrubullakësoni në miliona euro më të përafërt.**

## 1. Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare të grupit Fehmiu sh.a me 31 dhjetor 2024

<b>Pasuritë</b>	<b>€'m</b>
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>	
Prona, impiantet e prodhimit dhe pajisjet (L11)	988
Zëri i mirë (L12)	<u>26</u>
	1,014
Pasuritë qarkulluese (232 + 125 + 95 - (20 x 25 / 125))	<u>448</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>1,462</b>

### **Ekuiteti dhe detyrimet**

*Ekuiteti:*

Kapitali aksionar	50
Fitimet e mbajtura (L16)	480
Rezervat tjera (L18)	<u>242</u>
Ekuiteti i atribuar pronarëve të prindit	772
Interesat jo-kontrollues (L110)	<u>169</u>
	941
Detyrimet afatgjata (L14)	320
Detyrimet afatshkurta (L15)	<u>201</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>1,462</b>

### **Llogaritjet:**

#### **1. Prona, impiantet e prodhimit dhe pajisjet** **€'m**

Shumat e dhëna:

Fehmiu	500
Moisiu	225
Tosca	<u>210</u>
	935

Korigjimet:

Përitimet nga vlera e drejtë në blerjen e:

Moisiu (150 - [25 + 105 + 15]) 5

Tosca (200 - [25 + 140 + 22]) 13

Zhvlerësimi i akumuluar nga përfitimet e VD:

Moisiu (5/10) x 4 (2)

Tosca (13/5) x 2 (5.2)

Rivendosja e fabrikës së Fehmiu si shitje dhe marrje me qira

Transaksioni (shënim\* më poshtë) 50 x 9/10 45

Humbje nga zhvlerësimi Tosca që i atribuohet PIPP (L13) (2.8)

**988**

Shënim\* Transaksioni i shitjes dhe marrjes me qira nuk plotësonte kushtet e SNRF 15 për një shitje. Kjo për shkak se Fehmiu mbajti në thelb të gjitha përfitimet ekonomike në lidhje me pasurinë (ka të drejtë të përdorë pasurinë gjatë gjithë jetës së mbetur ekonomike). Prandaj, thelbi i transaksionit është ai i një huaje.

## 2. Zëri i mirë në blerjen e:

i) Moisiu	€'m
Kosto e blerjes (68+87)	155
IJK në blerje	39
Minus VD e PN të identifikueshme në blerje	<u>(150)</u>
Zëri i mirë në blerje	<u>44</u>
Minus humbja nga dëmtimi (L14)	<u>(18)</u>
<b>Shuma bartëse me 31 dhjetor 2024</b>	<b>26</b>

ii) Tosca	€'m
Kosto e blerjes	130
IJK në blerje 40% x 200	80
Minus VD e PN të identifikueshme në blerje	(200)
Zëri i mirë në blerje	10
Minus humbja nga dëmtimi (L14)	<u>(10)</u>
<b>Shuma bartëse me 31 dhjetor 2024</b>	<b>-</b>

## 3. Rishikimi i Moisiu dhe Tosca si NjGjP për dëmtim:

i) Moisiu	€'m
Shumat bartëse me 31 dhjetor 2024:	
Identifikueshme:	
E dhënë (ekuiteti)	240
Neto përfitimi VD (5 - 2)	3
Fitimi i perealizuar në stoqe 25 x 20/125	<u>(4)</u>
	239
Zëri i mirë	<u>44</u>
Total	283
Shuma e rikuperueshme (e dhënë në pyetje)	<u>265</u>
Total humbja (283 - 265)	18
<b>Alokuar te zëri i mirë</b>	<b>(18)</b>
ii) Tosca	€'m
Shumat bartëse me 31 dhjetor 2024:	
Identifikueshme:	
E dhënë (ekuiteti)	250
Neto përfitimi VD (13-5.2)	<u>7.8</u>
	257.8
Zëri i mirë 10 x 100/60	<u>16.7</u>
Total	274.5
Shuma e rikuperueshme (e dhënë)	<u>255</u>
Total humbja (274.5-255)	19.467
Alokuar te zëri i mirë (maksimum)	<u>(16.467)</u>
Saldo tek PIPP (nuk ka pasuri të tjera të paprekshme)	2.8
Humbja e alokuar tek zëri i mirë i njohur 16.7 x 60%	<b>10</b>

#### 4. Detyrimet afatgjata

	€'m
Shumat e dhëna:	
Fehmiu	175
Moisiu	63
Tosca	30
AKorigjimet:	
Pjesa jo afatgjatë e huasë të shitjes dhe marrjes përsëri me qira:	
Detyrimi me 31 dhjetor 2024 (60 x 1.1 - 9.8)	56.2
Detyrimi me 31 dhjetor 2025 (56.2 x 1.1 - 9.8)	<u>52.0</u>
	<b>320</b>

#### 5. Detyrimet afatshkurta

	€'m
Shumat e dhëna:	
Fehmiu	125
Moisiu	47
Tosca	25
Korigjimet:	
Pjesa afatshkurtë e huasë të shitjes dhe marrjes përsëri me qira (56.2-52)	<u>4.2</u>
	<b>201.2</b>

#### 6. Fitimet e mbajtura të grupit

	€'m
Fitimet e mbajtura Fehmiu	563
Pjesa e fitimeve të mbajtura pas blerjes e	
Moisiu (35%[105 - 80] + 80%[160 - 105])	52.75
Tosca (60%[170.5(L17) - 140] + 55%[175 - 170.5])	20.775
Korigjimet:	
Anulimi i përfitimit në rimatjen/shitjen e pasurive VDPFH	
- Moisiu (205 - 87 - 50)	(68)
- Tosca (165 - 15 - 130)	(50)
Përfitimi në çnjohjen e Moisiu si ortakëri:	
Vlera e drejtë në datën e çnjohjes	68
Vlera bartëse e ortakërisë (vlera e ekuitetit):	
Kosto	50
Pjesa pas blerjes e	
Fitimeve të mbajtura 35%(105-80)	8.75
Rezervave tjera 35%(15-10)	<u>1.75</u>
	<u>(60.5)</u>
	7.5
Zhvlerësimi i akumuluar i VD:	
- Moisiu 80% x 2	(1.6)
- Tosca (60% x 13 x 1.75/5 + 55% x 13 x 0.25/5)	(3.0875)
Fitimi i parealizuar në stoqe 4 x 80%	(3.2)
Anulim i përfitimit në shitjen dhe marrjen me qira të impiantit (60 - 50)	(10)
Kosto financiare në huanë e shitjes dhe marrjes me qira 10% x 60	(6)
Zhvlerësimi i impiantit të shitur dhe marrur me qira 50 / 10	(5)
Anulim i pagesave të qirasë	<u>9.8</u>

Humbjet nga dëmtimi (L13):		
- Zëri i mirë në Moisiu 80% x 18		(14.4)
- Zëri i mirë në Tosca	(10)	
- PIPP në Tosca		<u>(2.8)</u>
		<b>479.7375</b>

#### 7. Rezervat e Tosca me 1 tetor 2024

	Rezervat tjera €'m	Rezervat tjera €'m
Saldot me 31 dhjetor 2024	175	50
Minus fitimi për vitin 18 x 3/12	(4.5)	
Minus TTGJ për vitin 12 x 3/12	<u>-</u>	<u>(3)</u>
Saldot me 1 tetor 2024	170.5	47

#### 8. Rezervat tjera

	€'m
Rezervat tjera Fehmiu	189
Pjesa e rezervave tjera pas blerjes së	
Moisiu (35%[15 - 10] + 80%[55 - 15])	33.75
Tosca (60%[47(L17) - 22] + 55%[50 - 47])	16.65
Korigjime për reduktimin e mbajtjes në Tosca:	
Arkëtimet nga shitja	15
Pasuritë neto të identifikueshme të transferuar tek IJK (L19)	(12.5475) <u>2.4525</u>
	<b>241.8525</b>

#### 9. Neto pasuritë e transferuara tek IJK kur Fehmiu zvogëloi pronësinë në Tosca

	€'m
Pasuritë neto të identifikueshme të Tosca me 1 tetor 2024:	
Kapitali aksionar	25
Fitimet e mbajtura (L17)	170.5
Rezervat tjera (L17)	47
Neto përfitimi nga VD (13 - 13 x 1.75 / 5)	<u>8.45</u>
	<u>251</u>
Shuma e transferuar tek IJK 5% x 251	<b>12.5475</b>

#### 10. IJK në

i) Moisiu	€'m
Në blerje	39
Ndryshimet pas blerjes:	
Fitimet e mbajtura 20%(160 - 105)	11
Zhvlerësimi i VD 20% x 2	(0.4)
Fitimet e perealizuara 20% x 4	(0.8)
Humbja nga zëri i mirë 20% x 18	(3.6)
Rezervat tjera 20%(55 - 15)	<u>8</u>
	<b>53.2</b>



ii) Tosca

	<b>€'m</b>
Në blerje	80
Ndryshimet pas blerjes:	
Fitimet e mbajtura $[40\%(170.5 - 140) + 45\%(175 - 170.5)]$	14.225
Zhvlerësimi i VD $[40\% \times 13 \times 1.75/5 + 45\% \times 13 \times 0.25/5]$	(2.1125)
Neto pasuritë nga pronarët e prindit	12.5475
Rezervat tjera $[40\%(47 - 22) + 45\%(50 - 47)]$	<u>11.35</u>
	<b><u>116.01</u></b>
<b>Total IJK (53.2 + 116.01)</b>	<b>169.21</b>

## 2.

Një anëtar i Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SHKÇAK) së fundi është rekrutuar si Zyrtar Kryesor i Financave (ZKF) në Bolocco sh.a. Kompania kontrollohet nga një familje e njohur biznesi dhe anëtarët e familjes së ZKF-së kanë qenë miq shumë të ngushtë me pronarët e Bolocco sh.a-së për disa vite.

Shumica e stafit të departamentit të financave të Bolocco sh.a-së nuk kanë njohuri adekuate teknike në raportimin financiar për faktin se janë rekrutuar në bazë të marrëdhënieve personale, dhe jo në bazë të kualifikimeve dhe përvojës së kërkuar. Në disa raste, ZKF-së i është dashur të kryejë detyrat e tyre në përpjekje për të përmbushur afatet kohore ligjore dhe të brendshme të raportimit.

Në fund të vitit, kompania Bolocco sh.a pagoi një kosto të konsiderueshme për rinovimin e rezidencës private të Drejtorit Menaxhues. ZKF-ja u udhëzua nga Drejtori Menaxhues që ta konsideronte këtë pagesë si shpenzim të kompanisë, pavarësisht nga diskutimi që ai pati me ZKF-në që të njihet si detyrim prej tij ndaj kompanisë. Anëtarët e tjerë të Bordit të Drejtorëve nuk janë në dijeni për këtë transaksion. Drejtori Menaxhues është aksionari më i madh i Bolocco sh.a-së.

Më pas, ZKF i ofroi auditorit të jashtëm dokumente mbështetëse të falsifikuara për të vërtetuar transaksionin si shpenzim të kompanisë në mënyrë që të merrte një opinion të pakualifikuar auditimi prej tyre.

### **Kërkohet:**

- i) **Diskutoni çështjet etike që dalin nga faktet e dhëna më sipër në lidhje me pesë (5) parimet themelore etike sipas Kodit të Etikës të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve të adoptuar nga Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SHKÇAK). (5 pikë)**
- ii) **Rekomandoni veprimet që duhet të ishin ndërmarrë për të qenë në përputhje me parimet themelore etike. (5 pikë)**

## 2.

### (i)

Çështjet etike që dalin nga faktet e dhëna në lidhje me pesë parimet themelore etike sipas Kodit të Etikës së Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve:

- **Integriteti** – Trajtimi i gabuar i shpenzimeve për rinovimin e rezidencës së Drejtorit Menaxhues dhe ofrimi i dokumenteve të falsifikuara për auditorët. Kjo paraqet kërcënim e interesit personal dhe avokimit për integritetin.
- **Objektiviteti** – Presioni i bërë mbi ZKF-në nga Drejtori Menaxhues mund të kishte çuar në kompromentimin e gjykimit të tij profesional. Më tej, Drejtori Menaxhues është një mik shumë i ngushtë i familjes së ZKF-së. Kjo paraqet kërcënim të familjaritetit dhe frikësimit ndaj objektivitetit.
- **Kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur** – Ekipi i kontabilitetit për të cilin është përgjegjës ZKF-ja duket i paaftë, kështu që ZKF-ja përgatit dhe shqyrton raportet ligjore. Kjo paraqet një kërcënim të vetë-rishikimit.
- **Konfidencialiteti** – ZKF-ja nuk e ka sjellë këtë transaksion me palët e lidhura në vëmendjen e atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen, si Komiteti i Transaksioneve me Palët e Lidhura ose Bordi i Drejtorëve. Kjo paraqet një kërcënim të interesit personal.
- **Sjellja profesionale** – Trajtimi i gabuar i shpenzimeve për rinovimin e rezidencës së Drejtorit Menaxhues dhe ofrimi i dokumenteve të falsifikuara për auditorët. Këto akte nuk janë në përputhje me rregullat dhe rregulloret e kontabilitetit. Kjo paraqet një kërcënim të interesit personal.

### (ii)

- Pasi kishte marrë një pozitë të re, ZKF-ja duhet të kishte ngritur faktin se ai ndihej i shqetësuar për kompetencën e stafit në ekipin e kontabilitetit me menaxherët e tjerë të lartë të kompanisë. Të vepronte ndryshe do të rrezikonte kompetencën e tij profesionale dhe kujdesin e duhur. Pjesa e përgjegjësisë së ZKF-së do të jetë po aq e mirë sa stafi që punon brenda departamentit. Ai duhet të kishte hartuar një plan dhe një buxhet për përmirësimin e situatës, qoftë përmes trajnimeve shtesë ose mundësisht punësimit të stafit më shumë të kualifikuar.
- ZKF-ja duhet të kishte refuzuar të njihnte transaksionin e palëve të lidhura si shpenzim të kompanisë.
- Gjithashtu, ai duhet ta kishte sjellë këtë transaksion me palët e lidhura në vëmendjen e atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen si komiteti i transaksioneve me palët e lidhura ose bordi i drejtorëve. Gjithashtu, kjo duhej t'i raportohej auditorëve.
- ZKF-ja duhet të kishte kërkuar konsultim profesional nga Shoqata e tij, Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SHKÇAK).
- ZKF-ja nuk duhet të ishte përfshirë në përgatitjen ose miratimin e ndonjë dokumenti të falsifikuar. Nëse konflikti i pazgjidhur është kaq serioz, ai mund të japë dorëheqje nga posti i tij.

3.

(a) Bitri sh.a bleu një makineri të rëndë industriale për përdorim në operacionet minerare me një kosto prej €360,000 më 1 janar 2022. Ajo kishte një jetë të dobishme të vlerësuar prej 10 vjetësh dhe një vlerë të mbetur prej €20,000. Impiantet e prodhimit dhe makineritë zhvlerësohen në mënyrë lineare. Autoritete tatimore lejojnë zhvlerësimin si shpenzim të zbritshëm të llogaritur në 20% të koston së pasurisë në bazë lineare. Norma e tatimit është 10%.

**Kërkohet:**

**Shpjegoni qëllimin e aplikimit të tatimit të shtyrë dhe përgatitni ekstrakte nga pasqyra e fitimit ose humbjes dhe pasqyra e pozitës financiare të Bitri sh.a-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024 që tregojnë impaktin e tatimit të shtyrë. (5 pikë)**

(b) Josipi sh.a një entitet në industrinë e shërbimeve financiare përgatit pasqyrat financiare deri më 31 dhjetor çdo vit. Ngjarjet e mëposhtme kanë ndodhur të cilat janë të rëndësishme për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024:

i) Më 1 janar 2024, Josipi sh.a i dha hua €60 milionë një entiteti tjetër. Interesi prej €3 milionë është i pagueshëm çdo vit në fund të vitit. Një pagesë përfundimtare shtesë prej €70.6 milionë duhet të bëhet më 31 dhjetor 2026. Josipi sh.a shkarkoi kosto direkte prej €0.5 milion për kontraktimin e kësaj kredie. Norma vjetore e interesit e nënkuptuar në këtë marrëveshje është afërsisht 10%. Josipi sh.a nuk ka ndërmend t'ia shesë këtë kredi një pale të tretë. (5 pikë)

ii) Më 1 janar 2024, Josipi sh.a bleu 1,000,000 aksione në Golja sh.a i cili është furnitori kryesor. Aksionet u blenë për të mbrojtur burimin e furnizimit të Josipi sh.a-së dhe Josipi sh.a nuk ka ndërmend të tregtojë këto aksione. Aksionet kushtojnë €4 për aksion dhe kostot e transaksionit për blerjen e aksioneve ishin €200,000. Më 1 tetor 2024, Golja sh.a pagoi një dividend prej 60 cent për aksion. Më 31 dhjetor 2024, vlera e drejtë e një aksioni në Golja sh.a ishte €4.5. (5 pikë)

**Kërkohet:**

**Shpjegoni se si duhet të kontabilizohen transaksionet në (i) dhe (ii) më sipër në pasqyrat financiare të Josipi sh.a-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024. (Total 10 pikë)**

c) Malota sh.a është një shitës me shumicë dhe pakicë i produkteve harduerike me bazë në Kosovë. Është formuar njëzet (20) vjet më parë. Menaxhmenti i kompanisë ka filluar zbatimin e strategjisë së rritjes së kompanisë duke investuar në kompani të tjera konkurrencte direkte dhe indirekte. Malota sh.a bleu 16% të aksioneve të aksioneve në Gjoka sh.a për një shumë prej €120,000 më 1 janar 2024. Malota sh.a kishte kosto ligjore prej €7,000 për të përfunduar blerjen e aksioneve. Malota sh.a synon të shesë këto aksione kur vlera e tyre të jetë së paku €135,000. Gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2024, Gjoka sh.a ka realizuar fitim pas tatimit prej €10,000 dhe ka paguar dividendë prej €8,000. Investimi 16% në Gjoka sh.a kishte një vlerë të drejtë prej €132,000 më 31 dhjetor 2024.

**Kërkohet:**

**Këshilloni menaxhmentin e Malota sh.a-së se si duhet të trajtohet investimi i mësipërm në pasqyrat e tyre financiare të konsoliduara për vitin 31 dhjetor 2024. (5 pikë)**

### 3.(a)

Nevoja për tatimin e shtyrë lind për shkak të diferencave të përkohshme që ekzistojnë midis rregullave të kontabilitetit për njohjen e fitimeve dhe rregullave ekuivalente të tatimit. Këto diferenca potencialisht rezultojnë në njohjen e fitimeve në pasqyrat financiare në periudha kontabël të ndryshme nga periudha në të cilën entiteti është i detyruar të paguajë tatimin për fitime të tilla, duke çuar në një mospërputhje midis shpenzimeve tatimore në pasqyrën e fitimit ose humbjes kundrejt fitimit të cilit është duke iu ngarkuar. Qëllimi i tatimit të shtyrë është të lehtësojë këtë mospërputhje duke njohur efektin tatimor të transaksioneve në periudhën në të cilën transaksione të tilla njihen në pasqyra dhe jo periudhën në të cilën efekti tatimor realisht paraqitet në llogaritjen tatimore.

#### Ekstrakt - Pasqyra e fitimit ose humbjes

Shpenzimet / (te ardhurat) e tatimit në fitim (3,800) kredi

#### Ekstrakt - Pasqyra e pozitës financiare:

Detyrimet aftagjata

Detyrimet e tatimit të shtyrë €11,400

#### Llogaritjet

	Shuma bartëse	Baza tatimore	Diferenca e përkohshme kumulative
	€	€	€
Kosto 1 janar 2022	360,000	360,000	0
Zhvleresimi 2022 (€360,000 - €20,000)/10 vite	<u>(34,000)</u>		
Zhvleresimi 2022 sipas autoriteteve tatimore 360,000 x 20%		<u>(72,000)</u>	
31 dhjetor 2022	326,000	288,000	38,000
Zhvleresimi 2023 (€360,000 - €20,000)/10 vite	<u>(34,000)</u>		
Zhvleresimi 2023 sipas autoriteteve tatimore 360,000 x 20%		<u>(72,000)</u>	
31 dhjetor 2023	292,000	216,000	76,000
Zhvleresimi 2024 (€360,000 - €20,000)/10 vite	<u>(34,000)</u>		
Zhvleresimi 2024 sipas autoriteteve tatimore 360,000 x 20%		<u>(72,000)</u>	
	<b>258,000</b>	<b>144,000</b>	<b>114,000</b>

Andaj,

		€
Detyrimi tatimor i shtyrë më 31 dhjetor 2024 është €114,000 x 10%		11,400
Detyrimi tatimor i shtyrë më 31 dhjetor 2023 ishte €76,000 x 10% =		<u>7,600</u>
<b>Kritja e kërkuar në v/p 31 dhjetor 2024</b>		<b>3,800</b>

Debi Shpenzimi i tatimit në fitim 3,800

Kredi Detyrim i tatimit të shtyrë 3,800

**(b)**

**(i)** Meqenëse modeli i biznesit është të arkëtoj rrjedhat monetare kontraktuale dhe rrjedhat monetare përbëhen vetëm nga ripagimi i principalit dhe interesit, kjo pasuri matet me koston e amortizuar. Vlera kontabël fillestare e pasurisë financiare do të jetë €60.50 milion (€60 milion vlera e drejtë + €500,000 kosto transaksioni). Të ardhurat financiare të regjistruara nën kategorinë e të ardhurave nga investimet në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024 do të jenë €6.05 milion (€60.5 milion x 10%). Vlera kontabël e pasurisë financiare në pasqyrën e pozitës financiare më 31 dhjetor 2024 do të jetë €63.55 milionë (€60.5 milionë + €6.05 milionë - €3 milionë).

**(ii)** Meqenëse ky është një investim në aksione të cilat Josipi sh.a nuk ka ndërmend t'i shesë, Josipi sh.a mund ta matë investimin me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (me kusht që të jetë bërë zgjedhje e parevokueshme në njohjen fillestare). Meqenëse pasuria financiare matet me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, kostoja e transaksionit përfshihet në vlerën e drejtë fillestare të aksioneve (1,000,000 x €4 + €200,000) = €4.2 milion.

Vlera kontabël e pasurisë financiare në pasqyrën e pozitës financiare më 31 dhjetor 2024 do të jetë €4.5 milion bazuar në vlerën e drejtë të aksioneve në fund të vitit (1,000,000 x €4.5).

Diferenca (fitimi nga vlera e drejtë) prej €300,000 (€4.5 milion - €4.2 milion) do të njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Të ardhurat nga dividendët prej €600,000 (1,000,000 x €0.6) do të njihen si të ardhura në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

**c)** Trajtimi i investimit në pasqyrat financiare të konsoliduara do të varet nëse blerja e 16% në Gjoka sh.a nuk i jep Malota sh.a-së asnjë ndikim domethënës; ndikim domethënës; kontrollin ose kontrollin e përbashkët në shoqëri. Blerja i aksioneve të ekuitetit prej më pak se 20% në një entitet tjetër supozohet se nuk rezulton në ndikim domethënës, përveç nëse ka informacion për të kundërtën.

Investimi në Gjoka sh.a do të trajtohet si investim tregtar i klasifikuar si një pasuri me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në pasqyrat financiare të konsoliduara pasi ato mbahen për qëllimin e vetëm të shitjes dhe nuk ka asnjë informacion që sugjeron se Malota sh.a ka ndikim domethënës në Gjoka sh.a.

Investimi fillimisht do të njihet me vlerën e drejtë prej €120,000, duke përjashtuar kostot ligjore prej €7,000. Investimi do të rimatet në €132,000, vlera e drejtë e tij më 31 dhjetor 2024 dhe do të tregohet në pasuritë jo-qarkulluese. Diferenca ndërmjet vlerës së drejtë në 31 dhjetor 2024 dhe 1 janar 2024 prej €12,000 (€132,000 - €120,000) dhe dividendëve të marra prej €1,280 (16% x €8,000) do të dërgohet si e ardhur në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024. Ndërsa kostot ligjore prej €7,000 do të ngarkohen si shpenzim në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024. Ky trajtim është në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet Financiare*.

#### 4.

a) Ajeti sh.p.k u themelua disa vite më parë për të vazhduar biznesin si prodhues i lëngjeve të frutave. Covid-19 dhe menaxhimi i dobët e kanë zhytur kompaninë në humbje të cilat potencialisht po zvogëlojnë kapitalin e kompanisë. Pasqyra e pozitës financiare të kompanisë më 31 dhjetor 2024 është dhënë më poshtë.

	€'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>	
Prona, impiantet e prodhimit dhe pajisjet	44,000
Marka tregtare	90,000
Investimet	24,000
Zëri i mirë	<u>96,000</u>
	254,000
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>	
Stoqet	216,000
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	388,000
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	<u>130,000</u>
	<u>734,000</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>988,000</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>	
<i>Ekuiteti:</i>	
Akzionet e zakonshme (emetuar me €1.70 për aksion)	102,000
Rezerva e rivlerësimit	140,000
Fitimet e mbajtura	(10,000)
15% Aksione preferenciale të paribleshme (emetuar me €2 për aksion)	<u>18,000</u>
	250,000
<i>Detyrimet afatgjata:</i>	
12% Obligacione	300,000
15% Kredi afatgjatë	<u>140,000</u>
	440,000
<i>Detyrimet afatshkurta:</i>	
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	280,000
Mbitërheqja bankare	<u>18,000</u>
	<u>298,000</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>988,000</b>

#### Informata shtesë:

i) Vlerat e mëposhtme të pasurive janë vlera të likuidimit:

	€'000
Prona, impiantet e prodhimit dhe pajisjet	30,000
Stoqet	176,000
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	320,000
Marka tregtare	120,000

ii) Banka e Ajeti sh.p.k ka në hipotekë pronat, impiantet e prodhimit dhe pajisjet si garanci për mbitërheqjen bankare.

- iii) Aksionarët e zakonshëm kanë vendosur të injektojnë kapital shtesë prej 50 milionë aksionesh të emetuara në vlerë prej €2.50 secila. Përveç kësaj, një pjesë e kredisë afatgjatë prej 15% do të konvertohej në 10 milionë aksione të ekuitetit të emetuara në vlerën €2.50 secila.
- iv) Dividentët e aksioneve preferenciale dhe interesat e obligacioneve janë të papaguara që tre vjet dhe do të konvertohen në aksione të zakonshme prej €2.50 secila nëse pranohet skema e rikonstruktimit të kapitalit. Obligacioni është i siguruar me pasuritë e Ajeti sh.p.k, përveç pronës.
- v) €50 milionë euro të të pagueshmeve tregtare dhe të tjera prej €280 milionë ishin kreditorë preferencialë që kanë prioritet para kreditorëve të pasiguruar.
- vi) Shpenzimet e likuidimit janë vlerësuar në €10 milionë dhe kanë prioritet sikur kreditorët e siguruar.
- vii) Vlerat e likuidimit për pasuritë konsiderohen të rëndësishme në rast të ndonjë skeme të rikonstruktimit të kapitalit.

**Kërkohet:**

- i) **Llogaritni shumat që do të arkëtoheshin nga secili prej kreditorëve nëse kompania do të likuidohej. (5 pikë)**
- ii) **Përgatitni pasqyrën e pozitës financiare pas zbatimit të një skeme të rikonstruktimit të kapitalit. (10 pikë)**

**b)**

Më 24 korrik 2014, BSNK-ja publikoi versionin përfundimtar të SNRF 9 *Instrumentet Financiare*. Një nga çështjet e trajtuara në SNRF 9 *Instrumentet Financiare* është matja fillestare dhe e mëvonshme e pasurive financiare. Mënyra se si kontabilizohen pasuritë dhe detyrimet financiare në pasqyrat financiare varet nga klasifikimi i tyre. SNRF 9 *Instrumentet Financiare* kërkon që pasuritë financiare të maten fillimisht me vlerën e tyre të drejtë në datën e njohjes fillestare. Megjithatë, matja e mëvonshme e pasurive financiare varet nga klasifikimi i tyre për të cilin SNRF 9 *Instrumentet Financiare* identifikon tre alternativa të mundshme.

**Kërkohet:**

**Shpjegoni tre klasifikimet që SNRF 9 *Pasuritë financiare* identifikon për pasuritë financiare dhe bazën e matjes që është e përshtatshme për secilin klasifikim. Ju gjithashtu duhet të identifikoni çdo përjashtim nga klasifikimet normale që mund të zbatohen në rrethana specifike. (5 pikë)**



**4.a)****i)**Të ardhurat nga likuidimi:

	<b>€'000</b>
Prona, impiantet e prodhimit dhe pajisjet	30,000
Stoqet	176,000
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	320,000
Marka tregtare	120,000
Investimet	24,000
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	<u>130,000</u>
	<b>800,000</b>

Shpërndarjet:

## Kreditorët e siguruar:

Mbitërheqja bankare	(18,000)
Shpenzimet e likuidimit	(10,000)
12% Obligacione	(300,000)

## Kreditorët preferencial:

Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	(50,000)
-------------------------------------	----------

## Kreditorët e pasiguruar:

15% Kredi afatgjatë	(140,000)
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera (280,000 - 50,000)	<u>(230,000)</u>
	<u>(370,000)</u>
	<b>52,000</b>

## Aksionarët preferencial:

Dividenda në vonesë	(8,100)
Kapitali aksionar preferencial	<u>(18,000)</u>
	<u>(26,100)</u>

Për aksionarët e zakonshëm	<b>25,900</b>
----------------------------	---------------

Të gjithë kreditorët rikuperojnë 100% të kapitalit ose investimit të tyre. Aksionerët preferencialë rikuperojnë gjithashtu 100% të kapitalit të tyre si dhe plotësisht dividendin e tyre 3-vjeçare të papaguar. Megjithatë, aksionerët e zakonshëm rikuperojnë vetëm 25% (25,900/102,000) të kapitalit të tyre.

**Humbja maksimale**

	<b>€'000</b>
Prona, impiantet e prodhimit dhe pajisjet (44,000 - 30,000)	14,000
Stoqet (216,000 - 176,000)	40,000
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera (388,000 - 320,000)	68,000
Marka tregtare (90,000 - 120,000)	(30,000)
Dividenda preferenciale (18,000 x 15% x 3 vite)	8,100
Zëri i mirë	96,000
Fitimet e mbajtura	10,000
Rezerva e rivlerësimit	<u>(140,000)</u>
	<b>66,100</b>

Alokimi i humbjës maksimale

Humbja e plotë shpërndahet në kapitalin e zakonshëm të aksionerëve, pasi ata do të humbasin 75% të kapitalit të tyre kur zgjidhet opsioni i likuidimit, ndërsa aksionarët dhe kreditorët e tjerë rikuperojnë plotësisht investimet e tyre.

Verejtje: Propozime të tjera të arsyeshme janë gjithashtu të pranueshme..

Skema e propozuar/sugjeruar

- Zëri i mirë dhe një pjesë e disa pasurive duhet të shlyhen. Një humbje totale prej €66.1 milionë do të shlyhet për të riparuar pasuritë në vlerat e tyre reale.
- Kapitali i aksionerëve të zakonshëm të shlyhet me rreth 65%, ndërsa kapitali aksionar preferencial duhet të mbetet i njëjtë. Dividenda preferenciale 3-vjeçare do të konvertohet në aksione të zakonshme me €2.50 secila.
- Obligacionet 12% duhet të mbesin të njëjta dhe gjithashtu të sigurohet nga pasuritë tjera të kompanisë. Interesi i papaguar i borxhit trevjeçar do të konvertohet në aksione të zakonshme me €2.50 secila.
- Një pjesë e kredisë afatgjatë prej 15% do të konvertohet në 10 milionë aksione të zakonshme të emetuara me €2.50 për aksion.
- Kapitali shtesë prej 50 milionë aksionesh të emetuara me €2.50 secila do të mblidhet për qëllime të kapitalit qarkullues.

Verejtje: Propozime të tjera të arsyeshme janë gjithashtu të pranueshme.

ii)	<b>Pasqyra e pozitës financiare</b>	€'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>		
Prona, impiantet e prodhimit dhe pajisjet		30,000
Marka tregtare		120,000
Investimet		<u>24,000</u>
		174,000
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>		
Stoqet		176,000
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera		320,000
Paraja dhe ekuivalentët e parasë (L12)		<u>237,000</u>
		<u>733,000</u>
<b>Total pasuritë</b>		<b>907,000</b>
<i>Ekuiteti:</i>		
Akzionet e zakonshme (L11)		302,000
15% Aksione preferenciale të paribleshme		<u>18,000</u>
		320,000
<i>Detyrimet afatgjata:</i>		
12% Obligacione		300,000
15% Kredi afatgjatë (140,000 - 25,000)		<u>115,000</u>
		415,000
<i>Detyrimet afatshkurta:</i>		
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera (280,000 - 108,000)		<u>172,000</u>
		172,000
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>907,000</b>

## Llogaritjet:

<b>1. Kapitali i aksionarëve të zakonshëm</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim	102,000
Zvogëlimi i kapitalit	(66,100)
Kapitali i shtuar (50m x €2.50)	125,000
15% Borxhi afatgjatë i konvertuar (10m x €2.50)	25,000
Dividenda preferenciale	8,100
Interesi i obligacioneve (12% x €300,000 x 3 vite)	<u>108,000</u>
	<b>302,000</b>

<b>2. Paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim	130,000
Kapitali shtesë-aksionarët e zakonshëm	125,000
Mbitërheqja bankare	<u>(18,000)</u>
	<b>237,000</b>

b) Klasifikimi i SNRF 9 bëhet mbi bazën e që të dyjave:

- Modelin e biznesit të entitetit për menaxhimin e pasurisë financiare, dhe
- Karakteristikat e rrjedhave të parasë të kontraktuara të pasurisë financiare

Klasifikimi dhe matja e pasurive financiare të instrumentve të borxhit bazohet kryesisht në modelin e biznesit për menaxhimin e pasurisë financiare, veçanërisht nëse objektivi është mbajtja ose jo e pasurisë financiare në mënyrë që të mblidhen rrjedhat e kontraktuara të parasë dhe nëse rrjedhat e kontraktuara të parasë janë apo jo vetëm pagesa të kryegjesë dhe interesit mbi shumën e kryegjesë të papaguar.

1. Aty ku modeli i biznesit për menaxhimin e pasurisë financiare është mbajtja e pasurisë financiare për të mbledhur rrjedhat e kontraktuara të parasë dhe rrjedhat e kontraktuara të parasë janë vetëm pagesa të kryegjesë dhe interesit mbi shumën e kryegjesë të papaguar, atëherë pasuria financiare normalisht matet me **koston e amortizuar**.
2. Kur modeli i biznesit për administrimin e pasurisë është mbajtja e pasurisë financiar për të mbledhur rrjedhat e kontraktuara të parasë dhe për të shitur pasurinë financiare dhe rrjedhat e kontraktuara të parasë janë vetëm pagesa të kryegjesë dhe interesit mbi shumën e kryegjesë të papaguar, atëherë pasuria normalisht matet me **vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse**. Të ardhurat nga interesi për këto pasuri njihen në të njëjtën mënyrë sikur pasuria të matej me koston e amortizuar.
3. Në rrethana të tjera, pasuritë financiare maten normalisht **me vlerën e drejtë përmes profitit ose humbjes**. Pavarësisht nga sa më sipër, kur investimet e ekuitetit nuk mbahen për tregtim, një entitet mund të bëjë një zgjedhje të përvokueshme për të matur këto investime me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Një entitet mund, në njohjen fillestare, të përcaktojë në mënyrë të përvokueshme një pasuri financiare të matur me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, nëse për ta bërë këtë eliminon ose redukton ndjeshëm një mospërputhje kontabël.

5.

(a) John Belushi sh.a dhe James Belushi sh.a janë dy kompani në industrinë e veshjeve. Më poshtë janë koeficientët financiarë të llogaritura nga zyrtari kryesor financiar përkatës për secilën kompani bazuar në pasqyrat financiare më të fundit të audituara.

**Koeficientët e kompanive për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024**

	<b>John Belushi sh.a</b>	<b>James Belushi sh.a</b>
Norma e kthimit mbi kapitalin e angazhuar (KNKA)	24.10%	30%
Qarkullimi i pasurive	1.9 herë	2.5 herë
Marxhina e fitimit bruto	35%	20%
Marxhina e fitimit neto (para tatimit)	10.50%	12%
Koeficienti qarkullues	1.0:1	2.0:1
Koeficienti i shpejtë (testi acid)	0.8:1	1.0:1
Periudha e qarkullimit të stoqeve	60 ditë	90 ditë
Periudha e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme	58 ditë	60 ditë
Periudha e pagesës së llogarive të pagueshme	50 ditë	50 ditë
Borxhi / ekuiteti	50%	30%
Norma e kthimit të dividendëve	3%	2%
Mbulimi i dividendës	2 herë	1.5 herë

**Kërkohet:**

- i) Shpjegoni dy probleme që janë të natyrshme kur koeficientët përdoren për të krahasuar performancën e dy kompanive në të njëjtën industri. (2 pikë)
- ii) Analizoni dhe krahasoni performancën financiare dhe pozitën financiare të John Belushi sh.a dhe James Belushi sh.a. Analiza duhet të mbulojë performancën operative, likuiditetin, leven financiare dhe koeficientët e investimeve të aksionarëve. (8 pikë)

b) Më 1 janar 2024, Kodheli sh.a lidhi një kontratë me një klient për të ndërtuar një ndërtesë të specializuar për një shumë prej €1.2 milion plus një bonus prej €0.24 milion nëse ndërtesa përfundon brenda 18 muajve. Kostoja e vlerësuar për ndërtimin e ndërtesës është €0.9 milion. Nëse kontrata anulohet Kodheli sh.a mund të kërkojë nga klienti pagesën për koston e bërë deri më sot plus një marzhë prej 30%. Më 1 janar 2024, si rezultat i faktorëve jashtë kontrollit të saj, si moti dhe miratimi rregullator, Kodheli sh.a nuk është e sigurt nëse bonusi do të arrihet.

Më 31 dhjetor 2024, Kodheli sh.a ka pasur kosto prej €0.6 milion. Kodheli sh.a është ende e pasigurt nëse objektivi i bonusit do të arrihet. Kodheli sh.a ka vendosur të matë progresin drejt përfundimit bazuar në koston e shkaktuar. Deri më sot, Kodheli sh.a ka marrë €1 milion nga klienti.

**Kërkohet:**

**Rekomandoni drejtorëve të Kodheli sh.a se si duhet të kontabilizohet ky transaksion në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024 në përputhje me SNRF 15 Të hyrat nga kontratat me konsumatorët.** (5 pikë)

c) Destani sh.a importon pajisje të personalizuar nga Evropa dhe SHBA-ja për shitje në Kosovë. Është politikë e Destani sh.a-së që klientët e saj të bëjnë pagesën për blerjet e tyre një vit para dorëzimit. Destani sh.a nuk ofron zbritje për paradhëniet e pranuar.

Pagesa e paradhënieve i mundëson Destani sh.a-së të menaxhojë nivelet e importit dhe shpërndarjen e furnizimit për klientët e saj. Më 1 janar 2024, Destani sh.a mori €5 milionë nga një klient për të furnizuar një pajisje të personalizuar dhe më 31 dhjetor 2024, Destani sh.a dorëzoi pajisjet. Norma shtesë e huamarrjes së Destani sh.a-së më 1 janar 2024 ishte 10%.

**Kërkohet:**

**Në përputhje me SNRF 15 *Të hyrat nga kontratat me konsumatorët*, jepni shpjegime (me llogaritje dhe regjistrime, nëse është e nevojshme) se si skenari i mësipërm do të trajtohej nga Destani sh.a gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2024. (5 pikë)**

## 5.

### (a)

(i) Një shqetësim i veçantë për këtë menyrë të përdorimit të koeficientëve është:

- Shumë firma të mëdha operojnë divizione të ndryshme në industri të ndryshme. Për këto kompani është e vështirë të gjejnë një grup kuptimplotë të koeficientëve mesatar të industrisë.
- Firmat e ndryshme kanë profile të ndryshme të rreziqeve financiare dhe afariste dhe gjë që ka ndikim mbi analizat përkatëse financiare.
- Inflacioni mund të shtrembërojë keq pasqyrën e pozitës financiare të një kompanie. Në këtë rast do të ndikohen edhe fitimet. Kështu, një analizë e koeficientëve të një kompanie me kalimin e kohës ose një analizë krahasuese e kompanive të moshave të ndryshme duhet të interpretohet me gjykim.
- Faktorët sezonalë gjithashtu mund të shtrembërojnë analizën e koeficientëve. Kuptimi i faktorëve sezonalë që ndikojnë në një biznes mund të zvogëlojë mundësinë e keqinterpretimit. Për shembull, stoqet e një shitësi me pakicë mund të jenë më të larta gjatë verës në përgatitje për sezonin e kthimit në shkollë. Si rezultat, llogaritë e pagueshme të kompanisë do të jenë të larta dhe kthimi në pasuritë e saj më i ulët.
- Politikat dhe praktikat e ndryshme kontabël mund të shtrembërojnë krahasimet edhe brenda së njëjtës kompani (dhënie me qira kundrejt blerjes së pajisjeve, çmimi mesatar kundrejt FIFO, etj.)
- Është e vështirë të përgjithësohet nëse një koeficient është i mirë apo jo. Një koeficient i lartë i parës së gatshme në një kompani të klasifikuar historikisht në rritje mund të interpretohet si një shenjë e mirë, por mund të shihet gjithashtu si një shenjë që kompania nuk është më një kompani në rritje dhe duhet të ketë vlerësime më të ulëta
- Një kompani mund të ketë disa koeficientë të mirë dhe disa të këqinj, duke e bërë të vështirë të dallosh nëse është një kompani e mirë apo e dobët.

### (ii)

#### Performanca operative

- Koeficientët e performancës operative janë mjete që matin funksionin e disa operacioneve kryesore për një organizatë ose biznes. Në veçanti, këta koeficientë zbulojnë informacione se sa me efikasitet ajo organizatë apo biznes po përdor burimet për të gjeneruar shitje dhe para. Një kompani me koeficientë të lartë të performancës është në gjendje të përdorë një grup burimesh minimale për të gjeneruar nivele të larta shitjesh, si dhe një hyrje të konsiderueshme monetare.
- Duke përdorur marxhinën e fitimit bruto, John Belushi sh.a po operon më mirë se James Belushi sh.a. Kjo do të thotë se John Belushi sh.a është në gjendje të kontrollojë koston e prodhimit dhe në të njëjtën kohë të maksimizojë të ardhurat ose shitjet.
- Duke përdorur marxhinën e fitimit neto James Belushi sh.a (12%) po operon më mirë në krahasim me John Belushi sh.a (10.50%). Kjo do të thotë se James Belushi sh.a është në gjendje të kontrollojë më mirë shpenzimet operative në krahasim me John Belushi sh.a. James Belushi sh.a është më efikas në kontrollin e shpenzimeve.
- KNKA e James Belushi sh.a me 30% është më e lartë se KNKA e John Belushi sh.a 24.10%. Kjo do të thotë se James Belushi sh.a bën një punë më të mirë për përdorimin

e kapitalit të saj sesa John Belushi sh.a. Një KNKA më e lartë tregon përdorim më efikas të kapitalit. KNKA duhet të jetë më e lartë se kostoja e kapitalit të kompanisë; përndryshe tregon se kompania nuk po përdor kapitalin e saj në mënyrë efektive dhe nuk po gjeneron vlerë për aksionarët.

### Likuiditeti

- Koeficientët e likuiditetit analizojnë aftësinë e një kompanie për të shlyer detyrimet e saj afatshkurtëra. Me fjalë të tjera, këta koeficientë tregojnë nivelet e parave të një kompanie dhe aftësinë për të kthyer pasuritë e tjera afatshkurtëra në para për të shlyer detyrimet dhe obligimet e tjera afatshkurtëra.
- Koeficienti qarkullues përdoret kryesisht për të dhënë një ide të aftësisë së një kompanie për të shlyer detyrimet e saj (borxhit dhe llogaritë e pagueshme) me paasuritë e saj (para të gatshme, letra me vlerë të tregtueshme, stoqet dhe llogaritë e arkëtueshme). Si i tillë, koeficienti qarkullues mund të përdoret për të bërë një vlerësim të përafërt të shëndetit financiar të një kompanie. Për çdo €1 të detyrimeve afatshkurtëra, John Belushi sh.a ka €1 në dispozicion për të paguar detyrimet. James Belushi sh.a ka €2 pasuri qarkulluese për çdo €1 të detyrimeve afatshkurtëra. James Belushi sh.a ka më shumë se sa duhet për të mbuluar detyrimet e saj afatshkurtëra.
- Koeficienti i shpejtë mat shumën e pasurive likuide në dispozicion për çdo €1 të detyrimeve afatshkurtëra. Kështu, një koeficient i shpejtë prej 0.8:1 për John Belushi sh.a do të thotë që një kompani ka €0.80 pasuri likuide në dispozicion për të mbuluar çdo €1 të detyrimeve afatshkurtëra dhe James Belushi sh.a ka €1.0 të pasurive likuide në dispozicion të mbulojnë çdo €1 të detyrimeve afatshkurtëra.

### Leva financiare

- Koeficienti i levës financiare i referohet koeficientit të analizës themelore të nivelit të borxhit afatgjatë të një kompanie në krahasim me ekuitetin / kapitalin e punësuar të saj. Për të analizuar sasinë e borxhit që një kompani po ndërmerr në krahasim me ekuitetin e saj, në përgjithësi përdoret koeficienti i borxhit ndaj ekuitetit.
- Në përgjithësi, një koeficient më i ulët i levës financiare nënkupton një stabilitet më të madh financiar. Megjithatë, borxhi jo gjithëmonë është i keq. Huatë dhe detyrimet e tjera me interes fiks janë një mënyrë që kompanitë të përdorin vlerën e tyre për të rritur fitimet për aksionerët, kështu që koeficienti optimal i i levës financiare përcaktohet kryesisht nga kompania individuale në krahasim me të tjerat në sektorin e saj. Prandaj John Belushi sh.a me një koeficient borxhi ndaj ekuitetit prej 50% është më i rrezikshëm se James Belushi sh.a me 30%.

### Koeficientët e investimeve të aksionarëve

- Kthimi i dividendit është një mënyrë për të matur se sa rrjedha monetare po mirren për çdo euro të investuar në një aksion të ekuitetit. Me fjalë të tjera, mat se sa euro po mirren nga dividendët. Në mungesë të ndonjë fitimi kapital, kthimi i dividendit është efektivisht kthimi i investimit për një aksion. Duke supozuar se të gjithë faktorët e tjerë janë ekuivalent, atëherë, një investitor që kërkon të përdorë portofolin e tij ose të saj

për të plotësuar të ardhurat e tij ose të saj ka të ngjarë të preferojë aksionet e John Belushi sh.a mbi atë të James Belushi sh.a, pasi ka 3% të kthimit nga dividenti krahasuar me 2% të James Belushi sh.a

- Mbulimi i dividendit është koeficienti i të ardhurave neto të kompanisë ndaj dividendit të paguar për aksionarët, i llogaritur si fitim për aksion i pjesëtuar me dividendin për aksion. Ndhmon për të treguar se sa i qëndrueshëm është një dividend. Mbulimi i dividendit më pak se 1.5 mund të tregojë rrezikun e një uljeje të dividendit ndërsa më shumë se 2 shihet si i shëndetshëm. Investitorët do të preferojnë John Belushi sh.a me mbulim dividenti 2 krahasuar me James Belushi sh.a me mbulim dividenti 1.5.

**b) Bonusi është konsideratë e ndryshueshme. Ai përjashtohet nga çmimi i transaksionit sepse nuk ka shumë të ngjarë që të mos ndodhë një ndryshim i rëndësishëm në shumën e të ardhurave kumulative të njohura. Ndërtimi i ndërtesës duhet të konsiderohet si një detyrim i përmbushur me kalimin e kohës. Kodheli sh.a duhet të njohë të ardhurat bazuar në progresin drejt ndërtimit të ndërtesës.**

#### 1) Fitimi i përgjithshëm nga kontrata

	<b>€'000</b>
Çmimi / Të hyrat	1,200
Kostot deri me datë	(600)
Kostot për tu përfunduar (900 - 600)	<u>(300)</u>
<b>Fitimi i përgjithshëm</b>	<b>300</b>

#### 2) Progresi

Një metodë e inputit përdoret për të llogaritur progresin, duke qenë kostot e deritanishme në krahasim me kostot totale.  $600/900 = 66.7\%$  (ose 2/3)

#### 3) Pasqyra e fitimit ose humbjes

	<b>€'000</b>
Të hyrat (1,200 x 2/3)	800
Kosto e shitjes (900 x 2/3)	<u>(600)</u>
<b>Fitimi</b>	<b>200</b>

#### 4) Pasqyra e pozitës financiare

	<b>€'000</b>
Kostot deri me datë	600
Fitimi deri me datë	200
Minus: Pagesat e progresit të faturuara dhe të pranuar	<u>(1,000)</u>
<b>Detyrim i kontratës</b>	<b>(200)</b>

**c) SNRF 15 Të hyrat nga kontratat me konsumatorët kërkon që një entitet të njohë të ardhurat në një shumë që pasqyron çmimin që një klient do të kishte paguar për mallrat ose shërbimet e premtuara nëse klienti do të kishte paguar mjete monetare për ato mallra ose shërbime kur (ose përgjatë kohës kur) entiteti i transferon klientit mallrat ose shërbimet. Prandaj, shumat duhet të pasqyrojnë çmimin e shitjes në para të gatshme në datën e transaksionit.**



Kur një kontratë kërkon pagesë nga një klient në mënyrë të konsiderueshme përpara ekzekutimit, kontrata thuhet se përmban një komponent të rëndësishëm financimi, përveç rastit kur parapagimi është qartësisht për arsye të ndryshme nga financimi.

Nuk kishte asnjë komponent të rëndësishëm financimi në marrëveshjen midis Destani sh.a dhe klientit. Pagesa paraprake është bërë për të siguruar furnizimin e ardhshëm të pajisjeve dhe jo për t'i siguruar Destani sh.a-së financim.

Prandaj, çmimi i shitjes në para është shuma e marrë.

#### Hyrjet në kontabilitet

	<b>Debi</b>	<b>Kredi</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Me 1 janar 2024:		
Paraja	5,000	
Detyrim ndaj kontratës		5,000
Me 31 dhjetor 2024:		
Detyrim ndaj kontratës	5,000	
Të hyrat		5,000